




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.06.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3251/13, për z. Shaban Gollopeni – Drejtor i Drejtorisë së Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3251/13, për zyrtarin e lartë z. Shaban Gollopeni – Drejtor i Drejtorisë së Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe njëkohësisht pronar në bizneset private Shërbime Veterinare “Veterina” dhe N.T.SH. “Veterina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Gollopeni, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet, dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Ai ka konfirmuar se përveç funksionit të Drejtorit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë është edhe pronar në bizneset e përmendura private.

z. Gollopeni ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik dhe për të shmangur atë, me vullnetin e tij ka pranuar t'i mbyllë të dy bizneset në afat sa më të shpejtë.

Mirëpo, i njëjti, nuk i ka mbyllur në afatin e premtuar, prandaj Agjencia i ka dërguar atij edhe shkresën e dytë (shkresën paralajmëruese) me të cilën i është kërkuar që në afatin ligjor të shmang konfliktin e interesit. Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2320/14 dhe DPKI 03 - 2321/14) me të cilat vërtetohet se ai ka mbyllur bizneset në fjalë.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

